



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Planifikimit Strategjik
Periudha raportuese	<b>Shkurt, 2023</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Mimoza Sylejmani Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik

#### Projektet:

- Përfundimi i projektit konceptual për hapësirën publike në lagjen “Ulpiana” dhe përgatitja për prezantim;
- Përfundimi i paramasës për renovimin e Qendrave për të moshuar;
- Paramasa për renovimin e Qendrave për të moshuar dhe QPS;
- Pjesa e planifikimit të PZHK-së (në përfundim e sipër );
- Digjitalizimi i objekteve në zonat ku nuk ka matje gjeodezike (Hartën zonale dhe UN Habitatin);
- Digjitalizimi i kushteve ndërtimore 2021/2022;
- Digjitalizimi i vazhdimet të autostradës;
- Digjitalizimi i Unazës së qytetit ( versioni i dt. 16.2.2023);
- Digjitalizimi i korridoreve të zhvillimit Pan-evropian;
- Kompletimi i file-ve për nevoja të PRRD-së të lagjes “Kalabria”;
- Digjitalizimi i konceptit të zhvillimit komunal.

#### AKTIVITETET:

- Gjatë muajit shkurt, në Sektorin e planifikimit janë trajtuar gjithsej 45 lëndë;
- Informimi i palëve për kriteret e planeve, gjatë ditëve të caktuara për palë;
- Trajnim për menaxhimin dhe monitorimin e projektit, IKAP;
- Trajnim i stafit “Disiplina dhe ankimi në shërbimin civil” IKAP;

- Trajnim i stafit “Transferimi, pezullimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil” IKAP;
- Prezantimi dhe rishikimi i metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve – menaxhimi i emergjencave;
- Përgatitja e materialit për konsulta publike për bllokun D/2 të lagjes “Arbëria 3”.

## • TAKIMET:

- Takim pune me Kryetarin, Përparim Rama, dhe drejtorët, për dokumentin e PZHK-së;
- Takim pune me Arbër Sadikun dhe Idriz Maliqin - diskutim për trasenë finale të unazës së qytetit;
- Takim pune me Edona Dërgutin, për sqarime shtesë të zonave mbrojtëse të aseteve të trashëgimisë;
- Takim pune me grupin punues për hartimin e zgjidhjes urbane për Kampusin sportiv;
- Konsultime me Drejtorinë e Planifikimit dhe Drejtorinë e Mirëqenies Sociale për lokacionin e ri të QPS-së;
- Konsultime me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale lidhur me modifikimin e paramasës për renovimin e Qendrave për të moshuar;
- Takim pune me DSHP-në – diskutim për lokacionet e qoshqeve (kiosqeve);
- Takim pune me grupin punues për hartimin e zgjidhjes urbane për Kampusin sportiv, në lagjen “Zona Ekonomike” në Prishtinë;
- Takim informues me arkitektin e kompanisë “Kastrati” për prezantimin e projektit ideor të bllokut D/2 të lagjes “Arbëria 3”;
- Takim informues me grupin punues për hartimin e PRRH-së, të lagjes “Kalabria” në Prishtinë;
- Takim pune me përfaqësuesin e kompanisë “Pastrimi”, ku u diskutua për krijimin e strategjisë për mbeturina;
- Takim pune me Kryetarin dhe grupin punues të PRRH-së “Kalabria”, ku u diskutua dinamika e procesit të hartimit të këtij plani;
- Takim pune me Komisionin komunal për integrimin e personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës.

## VIZITAT NË TERREN:

- Vizitë në QPS dhe në Qendrat për të moshuar, për evidentimin e nevojave për renovimin dhe inventarizimin e këtyre hapësirave;
- Vizitë në çerdhen në lagjen “Dardania” – Inspektimi i punimeve dhe raportimi në MASHT;
- Vizitë në QPS (“Bregu i Diellit” dhe “Kodra e Trimave”);
- Verifikimi i lokacioneve për qoshqe - me DPSH.

